



Tiranë me ____ - ____ 2018

VENDIM Nr. 1

Lënda: Kriteret e vlerësimit, njohjes dhe ekuivalentimit të studentëve aplikues për transferim studimesh dhe program te dyte studimi.

Komisioni *ad-hoc* i ngritur me vendim të Dekanit, Nr.49, datë19.09.2018 për vlerësimin e kandidatëve të cilët aplikojnë për transferim të studimeve dhe program të dytë studimi, në përputhje me:

- o Ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë,
- o Udhëzimin Nr. 26, datë 30.07.2018 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr.18, datë 21.05.2018 “Për procedurat e aplikimit dhe te regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, në vitin akademik 2018-2019”,
- o Rregulloren Mësimore të UPT,
- o Shkresën e Drejtorisë së Kurrikulave pranë UPT, Nr. 1195, datë 16.09.2018 mbi kriteret për transferimin e studimeve.

vendosi kriteret specifike të vlerësuara me pikë si më poshtë:

- | | |
|---|---------|
| o Kriter 1. Mesatare e VKM e Shkollës së Mesme | 10 pikë |
| o Kriter 2. Kredite të fituara mbi ato të mundshme | 40 pikë |
| o Kriter 3. Mesatare e ponderuar e Shkollës së Lartë | 50 pikë |

Bazuar në sa më sipër komisioni vendosi kriteret e njohjes së krediteve:

- o Studenti nuk mund të transferohet nëse nuk ka fituar minimalisht 30 ECTS në programin e studimeve të mëparshëm.
- o Me transferimin e krediteve studenti shlyen të gjitha detyrimet që lindin nga lënda/moduli.
- o Notat e marra në programe të tjera studimi nuk transferohen. Procedura e transferimit parashikon vetëm transferim krediti. Në rregjistrin e notave në këto raste vendoset germa “T” (Transferim). Në rast paisje të studentit me listë notash, sepecifikohet se germa “T” shënon lëndët e transferuara në FAU nga një program tjetër studimi.
- o Me transferimin e kreditit studenti shlyen të gjitha detyrimet e lëndës.



- o Kreditet transferohen nëse kreditet e kryera janë sa 75% e krediteve të parashikuara në programin e studimit të FAU ose më shumë.
- o Komisioni *ad-hoc* përcakton vitin në të cilin rregjistrohet studenti që transferon studimet, kjo bazuar në Rregulloren Mësimore të UPT si më poshtë:
 - Studenti rregjistrohet në vitin e parë të studimeve nëse ka fituar deri në 29 ECTS nga viti i parë i programit të studimit në FAU.
 - Studenti rregjistrohet në vitin e dytë të studimeve nëse ka fituar të paktën 30 ECTS nga viti i parë i programit të studimit në FAU.
 - Studenti rregjistrohet në vitin e tretë të studimeve nëse ka fituar të paktën 80 ECTS nga viti i parë dhe i dytë i programit të studimit në FAU.
 - Studenti rregjistrohet në vitin e katërt të studimeve nëse ka fituar të paktën 140 ECTS nga tre vitet e para të programit të studimit në FAU.
 - Studenti rregjistrohet në vitin e pestë të studimeve nëse ka fituar të paktën 200 ECTS nga tre vitet e para të programit të studimit në FAU.

Komisioni *ad-hoc*

- | | |
|----------------------------------|---------|
| 1. Prof. Dr. Florian NEPRAVISHTA | Kryetar |
| 2. Dr. Etleva BUSHATI | Anëtar |
| 3. Dr. Denada VEIZAJ | Anëtar |
| 4. MSc. Daniel QAMO | Anëtar |
| 5. Prof. Asoc. Armand VOKSHI | Anëtar |
| 6. Dr. Juljan VELESHNJA | Anëtar |